


NENDORI

e përmasajshme letrare-artistike
shoqërore-politike

M. Ali Dini 1992

Artisti i Vasilë

5



125 vjetori i NAIM FRASHËRIT

Në këtë numër: Shkrime kushtuar Naimit. Romani ynë dhe vëllimi «Për ty»,
Arti i revizionistëve. Viktor Eftimiu. Vjersha të reja nga Dritëro Agolli. «Orga-
noni i B. Brehtit. Libra të reja. Ngjarje kulturalë etj.

NENDORI

Buron Kaceli: Minatorë, Gravurë në linoleum



Çmimi
3 lekë

NENDORI

Revistë e përmuajshme
letrare-artistike
shoqërore-politike

ORGAN I LIDHJES SË SHKRIMTARËVE DHE ARTISTËVE
TË SHQIPËRISË

Nr. 5 VITI XVIII I BOTIMIT MAJ 1971

L E N D A :

125-VJETORI I NAIM FRASHËRIT

	Faqe
DRITERO AGOLLI	Punove mirë, usta! 3
ALFRED ÇAPALIKU	Naimi në muzeun e Vjenës, <i>vjershë</i> 6
PIRO KUQI	Naimit, <i>vjershë</i> 7
ZIJA XHOLI	Humanizmi i Naim Frashërit dhe mësimet e tij morale 8
GJOVALIN SHKURTAJ	Naim Frashëri dhe gjuha letrare shqipe 34
NONDA BULKA	Naimi dhe fabulat 51
NAIM FRASHËRI	Gjuha e Zemrës — Lulja — Hëna— Dimri — Toka dhe njeriu — Jeti- mi — Atdheu, <i>vjersha</i> 55
	Naimi në disa fotografi 63

STUDIME DHE KRITIKA

DILAVËR DILAVËRI	Jeta e sotme revolucionare në ro- manin tonë. 79
VASIL MELO	Shënime kritike për vëllimin «Për ty» 89
ANDON KUQALI	Art dhe revizionistë 94

SHKRIMTARË TË NJOHUR

VIKTOR EFTIMIU	Mërgimtari — Pylli — Zambakë — Këngë prej Ballkanit — Mos i dë- gjo — Fëmijëria — Qëndis një cupë në dritare, <i>vjersha</i> 113
	Aleksandër Moisiu, <i>ese</i> 120

NËPËR VENDIN TONË

ARIAN KADIU	Kaleidoskopi i së ardhmes, <i>repor- tazh</i> 125
-------------	---

KRIJIME LETRARE

DRITËRO AGOLLI

Biri i saj — Në kryeqytet — Mbrëmje letrare — Milkpritja — Vagabondët — Dy fjalë poetëve që vijnë — Lopa — Vdiq një veteran — Për poezinë — Duke u mënduar për bukurinë — Mollët — O mjeshtri-punë — Duke udhëtuar në male — Themelet — Endërr? — Bukuria — Relikiet e humbura të heroit — Në qytetin e lashtë — Era — Vreshia — Puna — Peizazh me një re të bardhë — Çqetësimi — Natë, vjersha
V.I. Lenin, vjershë
Kupeja e vagonit HRPSH-70, tregim
Dy urat, tregim

Faqe

137

157

159

174

VJOLLCA LISI
ANASTAS KONDO

ALFRED KANINI

NGA TEORIA BOTËRORE E ARTIT

BERTOLT BREHT «Organoni i vogël» për teatrin 182

BOTIME TË REJA

● Litari i zjarrtë ● Njerëz dhe gurë ● Kur hapet perdja ● Zhurmojnë ujvarat. 233

NGJARJE KULTURALE ARTISTIKE

● Konferenca e kompozitorëve të rinj ● Olimpiada teatrale e Tiranës, 1971. 240

Në kopertinën I «Naim Frashëri» — vizatim nga A. Kuqali

Kryeredaktori: Fatmir Gjata

Kolegjumi i redaksisë: Andon Kuqali (sekretar i kolegjumit), Dilaver Dilaveri, Dhimitër Xhuvani, Eglantina Mandia, Fatos Arapi, Gjergj Zheji, Jakov Xoxa, Lavdie Leka, Pandi Mele, Sandër Çefa, Sterjo Spasse.

125-vjetori i NAIM FRASHËRIT

PUNOVE MIRE,
USTA!

Naimi është fëminia e poezisë sonë. Koha kalon, poezia rritet e maturohet, por për të mbetet e bukur fëminia. Dhe megjithatë Naimi nuk është vetëm fëminia e parë e poezisë sonë, por njëkohësisht ai është edhe babai i saj. Kur nisi të ndërtohej kështjella e poezisë sonë, ai ishte nga ustallarët e vërtetë që vuri gurin e parë të sigurt në themelet e saj. Për këtë gjithë brezat poetikë i kanë hequr dhe i heqin kapelën, se nga ai kanë patur ç'të mësojnë. Ai ka qenë, ndofta, punëtori zemërgjërë më i madhi i gjithë poetëve shqiptarë. Me punën e tij të rëndë krijoi në Shqipërinë e kohës së vet poezinë moderne, vjershërimin modern që gjer atëhere mungonte. Hoqi nga fjalori poetik gjithë vjetërsirat që ia merrnin frymën gjuhës së gjallë. Fjalënperlë e nxori nga pluhuri i kohës, e bëri të shkëlqejë me

ART dhe REVIZIONISTE

SHËNIME PËR ARTIN SOVJETIK TË VITEVE
TË FUNDIT

PARTISHMËRI E PARTISHMËRI

Sikur të mos dijë njeri se cilët janë revizionistët sovjetikë, sikur të mos dijë veprimtarinë e tyre tradhëtare të djeshme e të sotme, sikur të mos tregojë shumë vëmendje ndaj fjalëve të tyre, do të kujtonte se ato që thonë nëpër fjalime e shkruajnë ata nëpër gazeta janë e drejta vetë. Edhe drejtuesit e organizatave të tyre të artit dhe kritikët në fjalime e shkrime stërkademiçe, emfatike e të mërzitëshme betohen për revolucion e për klasë punëtoze, për leninizëm. Çdo gjë është e mbushur me fraza të gjata e shumë dekorative përzjerë me terma të shkëputura nga leteratura marksiste dhe të përpunuara në stilin burokratik.

Gjithë ky vërshim fjalësh të përgjithëshme, më të shumtën e herës nuk ka lidhje me praktikën krijuese. Edhe kur i referohen asaj, revizionistët koncepteve dhe termave u japin një kuptim tjetër nga ç'mund të kujtojë njeriu.

Kështu ata flasin edhe për partishmëri në art. Kësaj fjale i jepet një kuptim fare i ngushtë burokratik. Partishmëri, sipas revizionistëve sovjetikë, nuk domethënë që arti t'i shërbejë klasës punëtoze e revolucionit, internacionalizmit proletar, të mbajë anën e tyre, sipas tyre, partishmëri domethënë që artisti t'u shërbejë me bindje servile qëllimeve imediate të par-

tisë revizioniste. Kjo domethënë që të krijohet një art thjesht utilitar në shërbim të konjunkturave politike dredharake të partisë dhe të qeverisë së klikës revizioniste sovjetike.

Për këtë arsye drejtuesit dhe kritikët revizionistë shtrojnë detyra për «zgjerimin tematik» dhe arrijnë deri aty sa për qëllimet e reklamës së tyre demagogjike të bëjnë kërkesa nga më banalet. Sipas kritikut J. Kupcov («Iskustvo», 8, 1970) e ashtuquajtura reformë ekonomike revizioniste dhe pseudorevolucioni i tyre tekniko-shkencor, të cilët nuk kanë qëllim tjetër veçse t'ja përshtasin më mirë bazën ekonomike borgjezisë së re burokratike të Bashkimit Sovjetik, shtroka para artistëve detyra të ndërlikuara. Po le të mos keqkuptohemi. Nuk është fjala për të pasqyruar gjëndjen e vështirë në të cilën po i fut gjithnjë e më shumë klika revizioniste punëtorët dhe kolkozianët. Jo! Është fjala, për shembull, që të mos paraqiten aq shumë vepra kushtuar «njerëzve të profesioneve», të cilët ende kërkojnë shumë punë fizike: punëtorëve të guroveve e të rrugëve, ndërtesëve, montatorëve, metalurgëve... Prodhim i sotëm nuk është aq «i muskujve» siç e kujtojnë njerëzit e brezit të vjetër etj. etj.». Që, me gjithë sorollatjet e fjalëve të atij kritiku, prapëseprapë domethënë paraqitni në veprat tuaja, teknikën dhe industrinë tonë të stilit perëndimor dhe intelektualët.

Imperialistëve të rinj të Bashkimit Sovjetik u pëlqen shumë të vringëllojnë armët. Ata duan të trembin të tjerët duke shpallur se kanë armatime moderne dhe mjete të reja luftarake (nga të cilët mund të tremben vetëm tradhëtarët e frikacakët). Prandaj gjeneral majori E. Vastokov («Iskustvo», 5, 1970) sikur i qërton artistët që nuk i njohin këto gjëra e thotë se ushtarët tashti paskan ndryshuar me që përdorin mjete të tilla të mekanizuara etj. etj. dhe se «gjithë kjo është e re dhe kërkon parafytyrime të reja artistike», duke mos përfillur kështu krejtësisht se rëndësi për artin kanë vlerat moralo ideore të njeriut, pra edhe të ushtarit të thjeshtë.

Nga të tilla kërkesa në pikturën e në grafikën sovjetike kemi shumë kompozime, portrete, peizazhe ku vendin kryesor e zenë maqineritë e mjetet teknike dhe ku figura e njeriut nuk është gjithashtu veçse si një vegël plotësuese. Dhe në këto punime të zbrazëta nga përmbajtja shpirtërore çfaqen shumë qartë ndikimet e formalizmit të të ashtuquajturve art abstrakt,

art kinetik etj. Por në fund të fundit ato piktura e vizatime janë skematike e të thata.

Megjithatë, formalizmi e dekadentizmi nuk u gjetën komode për propagandën dhe demagogjinë revizioniste. Vepra të hapura kubiste, apo abstraksioniste, imitime të pop artit ose op artit etj. zyrtarisht nuk lejohen më në Bashkimin Sovjetik. Këto lloj forma të artit nuk u panë të vlefshme për t'u shërbyer ideve të tyre tradhëtare politike e ideologjike. Ato janë edhe forma mjaft diskredituese për ta dhe tepër hapur intelektualiste. Përveç këtyre formalizmi e dekadentizmi nuk u përgjigjen siç duhet aspiratave borgjeze konservatore të revizionistëve sovjetikë. Prandaj ata kanë përkrahur format akademike tradicionaliste.

Dhe s'është për t'u çuditur në qoftë se gjejmë analogji me Gjermaninë naziste. Hitleri i luftoi me egërsi hysterike veprat kubiste, abstraksioniste e të tjera dhe autorët e tyre në Gjermani, por kjo nuk e bëri aspak më të mirë regjimin e tij. Kurse ai përkrahur një art tradicional neoklasik, i cili dha krijimet më tmerrsisht të ftohta e të zbrazëta që njihen në historinë e artit.

Në shumë krijime karakteristike të pikturës, skulpturës dhe grafikës sovjetike të viteve të fundit vihen re dy prirje ose dy rryma kryesore tipike: një akademizëm neoklasik dhe një art, kryesisht i kavaletit, që ka marrë emrin «stili i ri» ose «stili i rreptë».

FALLSITET MONUMENTAL

Arti ka ligjet e tij. Sa më thellë dhe me vërtetësi të pasqyrojë atë realitet që i sugjeron jeta vetë aq më emocional e prekës do të jetë. Në qoftë se artisti do të përpiket ta përdhunojë realitetin dhe t'i imponojë krijimit artistik aspekte e ide të paqëna, ai do të jetë i rremë, fals.

Një fenomen i tillë po vihet re gjithnjë e më shumë në artin monumental sovjetik, në skulpturë dhe në pikturë si edhe në gjinitë e kavaletit. Shtypi sovjetik trumbeton në të katër anët se ata po realizojnë idenë e Leninit të propagandës monumentale dhe këtë e lidhin me monumentet që kanë ngritur nëpër qytete të ndryshme ose me afresket, mozaikët, vitrazhet e format e tjera të pikturës dekorative monumentale. Kjo është ana e jashtëme. Lenini në planin e tij të propagandës monumentale fliste për vepra arti, qofshin edhe

nga më modestet, një bust i thjeshtë, një pllakë e thjeshtë përkujtimore, të cilat të përjetësonin ngjarjet e figurat e mëdha revolucionare ose njerëzit e shquar të historisë që kanë dhënë kontribut të madh në përparimin e njerëzimit dhe të shërbenin kështu për propagandimin e ideve përparimtare e revolucionare. Monumentet dhe pikturat monumentale dekorative që ngrihen tashti në Bashkimin Sovjetik sikur nuk e plotësojnë këtë detyrë.

Një pjesë e mirë e ansambleve skulpturale janë ngritur në vendet ku kanë qenë kampet e përqëndrimit ose në varrezat e luftëtarëve të luftës së madhe patriotike. Këto ansamble janë mjaft komplekse. Shpesh ato priren të prekin njerëzit me ndjenjën e mëshirës ose t'i trembin duke ngjallur ndjenjën e tmerrit. Në grupet skulpturale të «Monumentit viktimave të fashizmit në Salaspils» një nga realizimet që lavdërohen më shumë nga kritika sovjetike, figurat e njerëzve janë dhënë si viganë shumë të deformuar e të llahtarshëm, siç duket për t'i bërë më ekspresivë. Ndërmjet tyre nuk mungojnë edhe skulpturat që e paraqesin njeriun duke u tërhequr zvarrë para xhelatëve nazistë që të ngjall ndjenjën e thyerjes shpirtërore e të poshtëritimit.

Pikturat, mozaikët, vitrazhet e mëdha që janë punuar në hotele, stadiume, shkolla dhe institucione të tjera me tema të tilla «të gjëra» si pushtimi i kozmosit, revolucioni i Tetorit, lufta patriotike janë krijime mjaft anemike e të shplara. Të kompozuara në një plan, figurat e njerëzve të njohur, ushtarët, gratë e të tjera janë dhënë në mënyrën më skematike dhe pa shprehje. Ka vetëm një preokupacion; nga pikpamja plastike të lidhen me arkitekturën e ndërtesës, por kjo është krejt formale.

Kohët e fundit gjithnjë e më shumë shohim kompozime që pretendojnë të jenë «epike» e sikur shpërthen një farë frymëzimi. Atëhere shohim «revolucionarë» që pozojnë, ushtarë sovjetikë që krekosen, kozmonautë foduj e përbuzës si në një tablo të piktorit N. Oveçkin me titullin pretencioz «Kalorës të qiellit». Po nxjerr krye megalomania e imperialistëve të rinj. Përndryshe kompozimet e tyre monumentale dekorative janë fare të zbrazta.

Mungesa e idealeve të vërteta përparimtare, pa folur më për ideale revolucionare, nuk mund të pjellë veçse një pikturë e skulpturë pompoze, të rreme. Ky

është një fenomen i përsëritur në historinë e artit. Borgjezia e re kërkon të mbulojë meskinitetin dhe boshllëkun e saj me maskën e lavdisë së epokave historike të shquara të së kaluarës. Prandaj nuk ka se përse të çuditemi në se në artin e Bashkimit Sovjetik lindin krijime krejt neoklasike siç është reliefi «Lavdija e punës» i M. Baburinit, të cilin kritika e quan «interesante» e formë «dekorativo alegorike», mishërim të temave «heroiko poetik» dhe «lartësuese poetike» që përmban në vetvete principe «solemne — reprezentative» e të «stërholluara poetike» etj. etj. Ja me ç'tërma janë stërvitur të shprehen kalemxhinjtë revizionistë, kurse në këtë rast nuk kemi të bëjmë veçse me një imitim të varfër e banal të sa e sa skemave të stërshtfrytëzuara të artit klasik.

TEMA E VARFËR E PUNËS

Të pakënaqur se arti nuk i shërben siç duhet propagandës së tyre demagogjike, revizionistët u bëjnë thirrje artistëve për «zgjerimin e diapazonit tematik». Duhet bërë «punë sistematike mbi temat e solidaritetit ndërkombëtar të punonjësve etj. etj.». «... Duhet të pasqyrohet «roli shumë i madh i klasës punëtore në shoqërinë tonë», se «Në punën e punëtorit, punonjësit të fshatit kolkozian, të shkencëtarit ka dhe heroizëm edhe guxim dhe ëndërrim poetik». («Iskustvo» 8, 1970). Fjalë të bukura. Po ç'të bësh kur vetë ata, me veprimtarinë e tyre e drejtojnë tjetërkund vëmendjen e artistëve. E ai punëtor apo fshatar sovjetik me çfarë heroizmi dhe ëndërrimesh poetike mund të paraqitet? Por revizionistëve u duhet «tema» sa për sy e faqe.

Në po atë numur të po asaj reviste, disa faqe më tutje, I. Kupcovi, në një artikull me titull «Poezia e punës», duke folur për punimet ku janë «mishëruar figurat e punëtorëve sovjetikë» në Ekspozitën kombëtare pansovjetike të vitit 1970, thotë: «Nga numri i përgjithshëm i eksponateve (rreth 800) vepra të tilla numëroheshin relativisht pak (rreth 30)». Por kjo nuk e shqetëson aq fort kritikun në fjalë: «E megjithatë ato përbënin një panoramë mjaft të gjërë të jetës industriale të vendit tonë». Të tillë zhonglerë të fjalës janë me të vërtetë të rrallë! Dhe, në se do t'u besojmë fjalëve të vetë kritikëve si I. Kupcovi, vetëm një a dy vepra prej atyre të tridhjetave mund të kenë vlera të vërtete



Sipër, tabloja e E. Mojseenkos «Toka» dhe poshtë, tabloja e F. Milesë «Njeriu me shatë». Tema e punës në «socializmin» revizionist dhe në kapitalizëm.



ta artistike, ndonëse për ne janë ideologjikisht të diskutueshme.

Në pikturën e skulpturën sovjetike, jo vetëm të ekspozitës së vitit 1970, puna, punëtori, puna e tokës etj. trajtohen në dy mënyra ose në dy drejtime kryesore. Një mënyrë trajtimi është manifestimi i jashtëm i sipërfaqshëm, skematik. Në këto raste shpesh duken edhe mënyra formaliste. Tema e punës ka shërbyer vetëm si pretekst, si leje kalimi për virtuozyt shkollor ose për lojra formash nën ndikimin e artit formalist borgjez, ndonëse ky ndikim nuk del gjithnjë i qartë e i plotë.

Mënyra ose drejtimi tjetër e jep punën si një mundim, raskapitje, si një dramë të zezë e të vazhdueshme. Zgjidhja që i japin artistët sovjetikë jo vetëm që nuk është revolucionare, po është pa rrugëdalje, është pesimiste, është tragjike. Kjo është e keqja. Megjithatë, këtu ka një thelb të vërtetë: puna në Bashkimin Sovjetik është bërë një angari, një vuajtje, ajo nuk jep gëzime, ajo është burim vuajtjesh si në vëndet kapitaliste. Tabloja e F. Moiseenkos «Tokë» e jep bukur këtë ide, Tre kolkozianë, një traktorist e dy teknikë të tjerë, në muzgun e rëndë, pas një dite pune, rrijnë të kapitur, njeri pi duhan i menduar, i dyti shikon anash, i mërzitur, i treti ka vënë duart në një ije dhe vështron tokën fare i hutuar. Por sidomos e rëndë, shtypëse është ngjyra kafe e zezë e tokës, e cila ze krejt tabllonë e nuk na le të shohim veçse një qoshe të horizontit të mvrejtur, nga e majta. A ka shumë ndryshim kjo tablo nga piktura e famëshme e piktorit realist frëng të shekullit XIX Mile «Burri me shatë»? Në frymë e në përmbajtje nuk ka pothuajse asnjë ndryshim. Të ndryshëm janë subjekti, kompozimi, vendi dhe koha, sepse Mileja e ka pikturuar tabllonë e tij njëqind e ca vjet më parë dhe fliste për gjëndjen e fshatarit francez në etapën e kapitalizmit.

HEROIZËM APO DEHEROIZËM

Tabloja e Moiseenkos, për çudi, rradhitet nga kritikët sovjetikë ndërmjet atyre pikturave e skulpturave që ata i quajnë heroike. Një radhë veprash të të gjitha llojeve e të të gjitha gjinive të artit sovjetik të këtyre dhjetë e më shumë viteve të fundit, duke i bërë jehonë ideve revizioniste, shtrëmbëronin esencën historike të luftës së madhe patriotike duke e paraqitur si një

ngjarje, e cila nuk u solli veçse fatkeqësi «njerëzve të thjeshtë», domethënë popullit sovjetik. Tablo lotësh e dëshpërimit për të vrrarët, lëngimi të pafund për të plagosurit, melankoli pa shërim për nënat. Piktori Korzhev pikturoi një sërë ose një kompozim të përbërë prej shumë tabllosh, siç e quajtën ata vetë, me titull «Të përvëlur nga zjarri i luftës». Seria e tabllove të tij pati shumë «sukses» në rrethet artistike, sepse që një nga ato vepra që, si shumë filma e vepra letrare, paraqisnin luftën si një fatkeqësi të madhe, e cila nuk i kishte sjellë veçse vuajtje popullit sovjetik dhe këto vuajtje vazhdonin. Personazhet e këtyre krijimeve nuk ishin më heronjtë e guximshëm që shpartalluan Gjermaninë naziste, por qenie që i qenë nënshtruar «me burrëri» fatalitetit të luftës, të vuajtjeve e të vdekjes. Me pak fjalë ato ishin antiheronj. Gjithë atmosfera e gjithë psikologjia, gjithë tingëllimi emocional i veprave të tilla përpiqeshin të bënin deheroizimin e epopesë së madhe. Edhe revolucioni socialist i Tetorit, edhe puna e madhe e popullit sovjetik në pesëvjeçarët stalinianë paraqitej e tillë. Por kjo u bë mjaft diskredituese për udhëheqësit revizionistë. Sikundër edhe në politikë, në lëmenj të tjerë të ideologjisë u thellua më shumë demagogjia. Aq më tepër se vepra si këto nuk pranoheshin si të vërteta nga publiku i gjërë.

Për të qetësuar pakënaqësitë që ndiheshin andej këndeje, për t'u paraqitur me një fytyrë tjetër, ideologët revizionistë në përgjithësi, e teoricientët e kritikët e artit për pjesën e tyre, filluan t'i kritikojnë nga pak vepra të tilla për «naturalizëm», për «zvogëlëm» të temës, etj. etj. bile folën edhe për «pacifizëm». Duke bërë, si të thuash përgjithësimin e kësaj prirjeje në artin e periudhës së viteve 60-të, kritikë K. Kravçenko shkruante: «Ç'është e vërteta, duhet thënë, se në vepra të veçanta u çfaqën prirje të «deheroizmit», të lidhura me mendimin e gabuar sikur gjoja heroika «pengon» që të tregohet jeta dhe ambjenti i njeriut të zakonshëm» («Iskustvo» 2; 1971). Është e qartë se këtu, sikundër edhe në shumë raste të tjera, po bëhen përpjekje për ta justifikuar me ca koncepte të ngushta teorike për artin. Mirëpo kush nuk e di se tendencat e «deheroizmit» në art erdhën bashkë dhe plotësuan kritikën krushoviane kundër «kultit të individit» e të tjera ide revizioniste?

Përveç kësaj, revizionistëve nuk u pëlqen të merren dhe aq me këtë kritikë. Në shtyp ata janë kufizuar vetëm në ndonjë frazë, kurse në praktikë nuk mund të thuhet se ajo prirje për «deheroizëm» nuk vazhdon. Ajo ka marrë vetëm një pamje pak si më të moderuar.

Nga gjithë kompozimi në seri i G. Korzhevit në shtypin sovjetik tashti është dukur vetëm tabloja e tij «Përcjellja». Dy ngjyra e sundojnë tabllonë: e kuqja e thatë e tullës dhe grija e fëlliqur. Një ushtar i shëmtuar, i parruar, por i dëshpëruar po përqafton të shoqen së cilën nuk i duket fytyra. Gjithë sfondi i tabllës është zënë nga një faqe e madhe muri të pasuvtuar ku duken disa radhë dritarësh të njëlljojtë. Atmosferë e rëndë, dëshpërim e mërzi. Kështu po niset ushtari në luftën kundër Gjermanisë fashiste. Dhe ky ushtar na quhet heroik.

Le të marrim një krijim të kohëve të fundit, tabllonë e T. Sallahovit «Deti i ri» pikturuar më 1970. Kompozimi paraqet një grup punëtorësh, të cilët, mbi një digë, vështrojnë se si vërshojnë ujrat në një rezervuar të ri. Ngjyrat janë të çelura, kishe për të thënë mjaft të gëzuara. Aspak të gëzuar nuk janë punëtorët, Katër prej tyre kanë kthyer shpinat e krrusura duke mbajtur xhaketat në duart e lëshuara. Njëri, i vetmi të cilit i duket fytyra, është kthyer përpara. Edhe ai është i thyer, tepër i zhytur në mendime. Bile mendja e tij nuk është fare këtu. Kjo nuk është një festë e gëzuar, as nuk na flet për mendime të larta filozofike. Këta qënkan «njerzit që nuk tërhiqen përpara vështirësive» (T. Kravçenko). Sikur nuk na e mbush dot mendjen ky kritik. Kjo, u bëka që të mos tregohet heroi me poza teatrale, por me «thjeshtësi».

Shkaku nuk është thjeshtësia. A mos vallë për thjeshtësi në tabllonë si «Prapavija» të J. Rakshës puna e njerëzve, grave e fëmijëve sovjetikë, gjatë viteve të luftës, është dhënë nën një dritë «të përditëshme», me disa personazhe që mbledhin patate në qetësinë më të zakonëshme, si në çdo kohë bile, me një qetësi që flet më fort për ditë paqeje se sa lufte? Ku është këtu «principi heroik»?

Kështu shfaqet «heroizmi» në disa tablo tipike të revizionistëve. Në të vërtetë antiheronjtë janë heronjtë e tyre. Ata edhe e shpjegojnë, justifikojnë këtë



«Heroizmi» në pikturën revizioniste sovjetike. Tabloja «Deti i ri» e T. Sallahovit.

gjë në kritikën e tyre. Ai ushtari që është qorruar e sakatuar në luftë dhe që tashti i bie fizarmonikës për të lypur, ai punëtori që nuk gjen gëzim në punën e tij janë «heronj» sepse vuajnë, megjithëse jeta e tyre nuk ka perspektivë ata prapë nuk gajnë, por «qëndrojnë si burrat» s'ka gajle se megjithëka janë dëshpëruar. I bukur justifikim revizionist i deheroizmit! Ky është në të vërtetë, një nënshtrim pa kushte ndaj fatit.

«STILI I RREPTË»

Deheroizmi është një nga aspektet ideologjike të «stilit të rreptë». Piktura e skulptura e rreme pompoze, e ilustruar, manifestative, e përciptë e me prirje neoklasike është njëra rrymë kryesore e artit sovjetik. Rryma tjetër është i ashtuquajti «stil i rreptë», ekzistenca e të cilit nuk pranohet zyrtarisht. Pranohen veprat dhe idetë e tij.

Tiparet e «stilit të rreptë» filluan të duken në pikturën e zhanrit, në skulpturën e kavaletit e në grafikën sovjetike që në fillim të viteve 60. Njëra nga tabllotë që e përmbante në embrion ishte «Ndërtuesit e Bratskut» e V. Popkovit. Pesë punëtorë kanë pozuar para nesh, secili veç e veç, tre në këmbë e dy të ulur. Ata vështrojnë të heshtur përpara, pak të lodhur, pak të menduar, pak të trishtuar. Sfondi i tabllës është i errët e i papërcaktuar. Tashti ky stil është mjaft i kristalizuar, ka marrë shprehje më të plota artistike në punën e vazhduar e konseguente të një radhe piktorësh e skulptorësh sovjetikë. Piktorë të rinj, me personalitete të ndryshme si D. Zhilinski, T. Sallahov, G. Korzhëv, F. Moiseenko e të tjerë, secili në mënyrë të parvarur, nga njëra vepër në tjetrën arritën të japin qartë tiparet e kësaj rryme, gjë që tregon se nuk kemi të bëjmë me një fenomen të rastit. Dy tre vitet e fundit është bërë interpretimi teorik i këtij stili. Principet e tij estetike u shpalosën fare mirë në një diskutim që zgjati dy vjet në faqet e revistës «Tvorçestvo».

Një nga autorët më të njohur të «stilit të rreptë» është F. Iltneri. Një nga tabllotë e tij më të popullarizuara është «Pavdekësija». Nga tema, ideja dhe forma ajo përmban shumë nga elementët tipikë të «stilit të rreptë». Katër ushtarë, që duken më fort si të kohës së revolucionit, me ngjyra gri jeshile, në këmbë, drejt, mbajnë në duart e ngritura lart një shokun e tyre të vvarë. Sfondi, gjithashtu i papërcaktuar mirë, është i kuq flake, i rëndë. Fytyrat e vrazhda të ushtarëve janë të gjitha njësoj, shumë skematike, bile me detale të tilla si sytë, të pa përpunuara fare. Qëndrimi i ushtarëve është i ngrirë, më i ngrirë është ushtari i vdekur që ata kanë ngritur lart si flamur, simbol. Gjymtyrët e tyre, e veçanërisht të ushtarit të vdekur, janë si drasa të vjetra të thyera. Me këto gjëra tabllaja bën përshtypje dhe të sugjeron idenë e përjetësisë së vdek-

jes për ushtarët e revolucionit dhe për të gjithë ushtarët.

Piktorët e «stilit të rreptë» synojnë të krijojnë tablo «historiko filozofike». Nuk është e rastit që subjektet e tyre i marrin më fort nga revolucionit i terrorit e lufta patriotike dhe, më pak, nga puna ose pushimi pas pune. Ata nisen nga «ngjarje të vogla» të njerëzve «të vegjël» të panjohur, të turmës për të bërë «përgjithësime historike». Duke u nisur nga njerëzit e vegjël ata përpiqen të lidhen me ta, t'u bëjnë rezonancë ndjenjave të tyre. Këtu qëndron dhe rreziku. Duke i prekur njerëzit në ndjenjat e tyre intime një art i tillë përpiqet të ushqejë pesimizmin mikroborgjez se jeta është e mjerë, se revolucionit e lufta për mbrojtjen e atdheut janë të kota, se e ardhmja e njeriut nuk ka prespektivë, se lumturinë duhet ta kërkohet duke u mbyllur në jetën tënde familjare e personale.

Siç e shpjegojnë teoricienët e tij, «stili i rreptë» një ngjarje të zakonshme, të përditëshme, e transformon me një përgjithësim artistik me qëllim që të zbulojë ligjëshmëritë e jetës, duke u përpjekur të shprehet me koncepte, të mos merret me «tregimin» e ngjarjeve, por të japë perceptime të përgjithëshme për botën. Këto janë në të vërtetë qëllimet e artit të vërtetë në të gjitha kohrat. Por si i bën këto përgjithësimet «stili i rreptë» dhe në çfarë idesh për jetën e për botën arrin?

Shpesh në krijimet e tij ambientet janë të papërcaktuara dhe ngjyrat sa më konvencionale, simbolike kështu që vepra largohet sa më shumë nga konkretësia historike. Figurat e njerëzve më të shumëtën e herës «pozojnë» si para aparatit fotografik, rrinë të ngrirë, kanë vështrim të habitur e të papërqëndruar, gojën e shtrëngojnë që të heshtin, nuk komunikojnë me njeri tjetrin. Tiparet e tyre nuk kanë individualitet, jepet vetëm karakteristika sociale, njeriu jepet si «turmë» E vitohen dritë-hijet e refleksët, nuk jepet efekti i atmosferës, ngjyrat shpesh janë me sipërfaqe të qëruara e të prera. Të gjitha këto, së bashku me subjektet që shtjellojnë japin përgjithësimin artistik të një ndjenje tragjike pa rrugëdalje, japin parafytyrimin e një bote ku sundon trishtimi e vdekja. Çfarë ligjëshmërie të jetës zbulon pra ky art? Ai e fallsifikon jetën.

Ai quhet «stil i rreptë» (rus. Surovij = i ashpër, i egër, i rreptë) sepse është i xhveshur nga detajet, shpesh ka fakturë trashanike dhe sepse pretendon të

shprehë mendime të rrepta, të rënda, «pa sentimentalizma». Ai pretendon t'i drejtohet më fort mendjes, intelektit të publikut se sa ndenjave të tij, prirjet të përdorë mjetet figurative krahasuese, metaforike e alegorike për të arritur në përgjithësimet ideo-simbolike. Këto gjithashtu janë synimet e artit të madh e të vërtetë. Por piktura, skulptura, grafiKa sovjetike e «stilit të rreptë» kërkon të arrijë në përgjithësimet ideosimbolike të deheroizimit, të pesimizmit, të individualizmit, të tërë-fuqisë së vdekjes. A mund të krijohet një art i madh e i vërtetë me këto mendime e ide, me këtë botkuptim?

Në tabllonë e F. Frisherit «Na udhëhiqte rinia» është parafytyruar një moment «i zakonshëm» nga revolucioni i Tetorit. Një grup kalorësisht të rinj hidhen në sulm duke lënë pas një shokun e tyre të vranë pranë një feneri. Tablloja është kompozuar në një mënyrë të tillë, që nënvizohet largimi i kalorësve dhe syri ndalet tek ushtari i kuq, i ri, i vranë. I. Koçetovi («Tvorçestov» 3. 1970) duke e komentuar këtë vepër, të cilën ai e quan të «stilit të rreptë», shkruan se sipas tij, piktori ka dashur të thotë se: «nuk është e mundur të pajtohesh me vdekjen e një njeriu, edhe në qoftë se kupton domosdoshmërinë e kësaj sakrifice». Komenti e shpjegon mirë përmbajtjen ideo-artistike, revizioniste të veprës si edhe të shumë të tjerave si kjo.

Ndonëse nuk tregojnë ngjarje të ndërlikuara, por vetëm ngjarje të vogla nga jeta e përditëshme, tabllotë e këtij stili janë në traditën e pikturës ruse tregimtare të zhanrit. Edhe kjo është një nga mënyrat për të tërhequr më shumë interesin e një publiku më të gjërë.

Kritika zyrtare dhe drejtuesit e organizatave të artit të Bashkimit sovjetik, në esencë nuk kanë asgjë kundra «stilit të rreptë». Ata vetëm nuk e pranojnë zyrtarisht se do të prishej pamja e «unitetit» të tyre ideologjik. Prandaj ngulin këmbë duke thënë se në «njohjen e re, aktive të botës kombinohet njëlloj me sukses dhe konkurojnë edhe principi i sendeve edhe simbolizmi edhe metaforika ekstreme» (L. Djakonjicin, «Tvorçestvo», 7. 1970) «Piktori e bën publikun të bashkëndjejë dhe të mendojë së bashku me heroin e tij». (Ponomariov. «Iskustvo», 1. 1971). Dhe arrijnë në përfundimin se rrymat e tendencat e ndryshme që vihen re tregojnë se arti sovjetik shfrytëzoka pasurinë e të gjitha metodave të veçanta që ka krijuar njerëzimi gjer më sot dhe se me këtë «bashkëveprim të metodave bë-

het pasurimi krijues i metodës kryesore të artit sovjetik» që ata, me hipokrizi, e quajnë realizëm socialist (po aty). Kështu teoricienët sovjetikë pretendojnë se me neoklasicizmin e tyre pompoz nga njëra anë e me krijimet e «stilit të ri» nga ana tjetër paskan krijuar një art më të avancuar se ai i epokave të mëparëshme të njerëzimit. Edhe këtu çfaqet mëndjemadhësia e tyre e padurueshme.

Nuk mund të themi se krijimet e «stilit të ri» nuk janë të singerta. Ato pasqyrojnë një gjëndje shpirtërore të vërtetë që egziston në Bashkimin Sovjetik. Kjo është fryma e rënies së idealeve e meskinitetit mikroborgjez, e deluzioneve që ka krijuar ardhja në fuqi e klikës revizioniste, restaurimi i kapitalizmit. Ndofta edhe këtij sinqeriteti i tremben revizionistët. Por së bashku me këto ndjenja vjen edhe fryma antirevolucionare e atij stili.

IDEALIZËM E MISTIKË

Kur flasim për veprat e «stilit të rreptë» apo të rrymave të tjera në artin sovjetik, nuk është fjala për një e dy piktura apo skulptura melankolike ose të trishtuara. Është fjala për ndjenja e ide që shfaqen në mënyrë konsekuente në shumë vepra dhe që kanë edhe një metodë artistike konsekuente.

Brenda «stilit të rreptë» në artin sovjetik po marrin formë artistike prirje të reja më të përcaktuara idealiste e mistike. Kjo duket nganjëherë si origjinalitet forme e stili, kurse, në të vërtetë, është një prirje ideo-artistike.

Parafytyrimi i figurave pa lidhje gjestesh e shprehesh ndërmjet tyre, pak e nga pak po transformohet në parafytyrimin e figurave dhe objekteve të veçuar nga njeri tjetri brenda një kompozimi. Në këtë formë mpleksen dy elementë ideologjikë: individualizmi dhe idealizmi.


Tablloja «Bimët» e S. Muradjanit është tipike nga pikpamja e stilit. Kompozimi përbëhet nga një fushë e mbjellë me drurë të thatë pemësh, trungjet e të cilëve janë të lyer me gëlqere, ku rrijnë veç e veç: një djalë i ri, dy vajza të reja dhe një tjetër vajzë e re. Që të katër këta të rinj janë të hollë, të gjatë e të thatë si drurët e pemëve, sikundër është e thatë gjithë

tabloja, gjithë atmosfera. Çfarë ka dashur të thotë piktori? Të krahasojë drurët e thatë para gjelbërimit me figurat e të rinjve? E pastaj? Po kjo është një filozofi shumë e cekët. Së bashku me ca gurë njëngjyrësh të grumbulluar në mesin e kompozimit, mbi një tokë pa bar, tabloja të çon më fort në atmosferën e një lloj pikturë surealiste.

Më mirë janë mpleksur e konkretizuar idetë e individualizmit dhe të idealizmit në tabllonë e V. Popkovit «Familja e Bollotovëve.» Që nga tabloja e tij «Ndërtuesit e Bratskut» e deri te kjo e fundit, piktori ka evoluar shumë. Tabloja parafytyron, të vendosur në një plan, gruan, fëmijën e vogël, burrin, në ambientin intim të shtëpisë së tyre. Të tri figurat qëndrojnë si në vete, sikundër edhe macja dhe objektet shtëpijake. Vetëm nëna mban në duar fëmijën që lot, por vështron në anën tjetër, nuk merr pjesë psikologjikisht në këtë lojë. Le të shohim si e komenton kritikë L. Akimov («Istikustvo», 9, 1970). «Në tabllonë e re, thotë ai, Popkovi tregon si të mbyllur në rrethin e botës familjare, jetën e një familjeje të zakonëshme qytetare që nuk dallohet për asgjë... Heronjtë e tij janë si të mbyllur në ambientin e tyre shpirtëror e material. Heronjtë nuk çfaqen me lidhje reciproke, ekzistojnë në mënyrë të pavarur. Por gjithashtu «më vehte» jetojnë objektet... Jetën e mbyllur të çdo njeriu dhe unitetin e tij...» paraqet piktori etj. etj., për të mos u zgjatur me citime profesionale.

Më sinjifikative është krijimtaria e D. Zhilinskis dhe sidomos kompozimi i tij i fundit «Nën mollën plakë» i lavdëruar shumë nga kritika sovjetike. Stili i tij u përcaktua mirë me figurat disi të ngrira, me vizatimin e hollë e të prerë, me ngjyrat jashtë mase të pastra, me mungesën e dinamikës në lëvizjet e në shprehjen e fytyrës. Tabllotë e tij, duke nisur me «Studentët», dhe «Sportistët», e duke vazhduar me triptikun «Tokat e reja» gjithnjë e më shumë krijojnë përshtypjen e një bote të ftohët e të çuditëshme, pa atmosferë dhe që i afrohet parafytyrimit të një ëndërre.

«Nën mollën plakë» e D. Zhilinskis është një kompozim filozofik me shumë doza misticizmi. Një grua plakë, mbledh në barin e gjelbër, mollët e kuqe që ka lëshuar poshtë një dru i vjetër. Aty pranë është nipi i plakës, më tutje mbesa e saj pak më e madhe, edhe ata me mollë në duar. Siç mësojmë nga artikujt e botuar në shtyp, këta janë nëna dhe fëmijët e piktorit.



Një atmosferë e ngjashme ofron tabllonë e S. Muradianit «Binët» me tabllonë e «surrealistit abstrakt» Iv Tangi.

Ndërmjet tyre nuk ka komunikim me gjeste, ose me psikologji. Të tre rrijnë pak si të ngrirë, secili për hesap të vet. «të pavarur», dhe pa lëvizje psikologjike të fytyrës. Dallohen vetëm nga karakteret. Figurat lidhen vetëm nga vija e kompozimit, e cila, së bashku me degët e drurit, krijon një rreth të mbyllur. Të ngrira janë edhe ngjyrat. Njerëzit dhe objektet jetojnë në një ambient pa atmosferë si ato bimët e insektet në xhamet e koleksioneve. Kjo është ideja e botës së përjetëshme, të mbyllur të familjes, çerdhe irrealitete lumturie jashtë lidhjeve të shoqërisë, të historisë, të kohës, sipas tyre e vetmja botë e qëndrueshme dhe e vlefshme. Ky lloj kompozimi, këto forma të çuditëshme shprehin «tendencën për të zgjatur momentin e parafytyruar... Kjo tendencë... zhvillohet me përforsimin e abstragimit të përmbajtjes së tabllës, sepse abstragimi nga vetë natyra e tij ka karakter jashtëkohor». Kështu i komenton I. Koçetovi këto lloj tabllosh.

Por ky abstragim me personazhe pa tipare individuale, me ambiente, vëltime, ngjyra sa më të shkëputura nga realiteti, kjo botë e ngrirë dhe kjo përmbajtje e turbullt nuk janë gjë tjetër veçse misticizmi i artit bizantin, pa qenë përsëritja e tij.

Në tabllonë e D. Zhilinskit përveç të tjerave, kupitimi mistik, metafizik i jetës përforcohet edhe me një element tjetër, në vështrim të parë, kurioz. Në dy korнизat anësore, në katërkëndësha këndrejtë, të vegjël piktori ka pikturuar në njerën anë të jatin dhe, në anën tjetër, të vëllanë. Nën secilin prej tyre ka vënë datat e vdekjes. Babai ka vdekur shumë e shumë vite më parë, vëllai është vrarë në luftën e dytë botërore. Një formë të tillë e gjejmë nëpër ikonat. Këtu kjo shërben për të përforcuar idenë e qarkut të mbyllur të jetës familjare: babai dhe vëllai kanë dalë jashtë kështij rrethi, kanë shkuar në «jetën tjetër».

Metafizika dhe sidomos idetë e mëshirës kristiane dhe misticizmi ka kohë që kanë filluar të duken, ku më shumë e ku më pak, në artin sovjetik. Imitimi i ikonave ose i disa skemave të artit fetar të mëvonshëm është dukur në një radhë «madonash» partizane, të revolucionit e të tjera. Në një nga krijimet e fundit «Ushtari i vendit të sovjetëve» i piktorit B. Shatohin nuk ka shumë ndryshim nga ëngjëjt dhe shenjtorët e pikturës ruso-bizantine.

Duke vazhduar mbrojtjen e «stilit të ri» I. Koçetovi shkruan: «Disa herë janë përpjekur t'i shpjegojnë



Fragment i tabllës S. B. Shatohinit «Ushtari i vendit të Sovjetëve» dhe fragment i një afresku të shekullit XII në Vladimir, Rusi. Është fare e qartë fryma e përbashkët mistiche.

(tiparet e këtij arti. A. K.) me tërheqjen ndaj piktures së mesjetës. Po ky nuk është shkak, por rrjedhim». Shqip, d.m.th. se janë fryma, idetë e lindura në rrethanat e restaurimit të shoqërisë me klasa në Bashkimin Sovjetik që po pjellin një art me një përmbajtje të tillë. Në këto rrethana po gjallërohen besimet fetare edhe po ringjallet Rusia e shenjtë, shteti burokratik mbështetur në intriga e hipokrizi të stilit bizantin, populli ndjen peshën e shfrytëzimit dhe nuk e di se nga i vijnë fatkeqësitë. E gjithë kjo gjëndje shpirtërore do të shprehet, natyrisht, edhe në art.

I tillë është arti që mund të lindë nga ideologjia e revizionistëve e gërshetuar me demagogjinë e tyre politike. Ose falsitet pompoz, me disa prirje neoklasike sot për sot, ose një art tradicionalist e akademik i mbështetur më fort në llojet e zhanrit që shpreh melankoli e dëshpërim dhe individualizëm mikroborgjez me prirje metafizike e mistike. Këto janë tashti rrymat kryesore, karakteristike të artit sovjetik.

Pa dyshim, ka në Bashkimin Sovjetik edhe artistë të ndershëm, por që janë të hutuar nga propaganda diversioniste e revizionistëve. Ka edhe artistë përparimtarë e revolucionarë. Sikur ata të krijojnë piktura e skulptura e vizatime që zbulojnë deri në fund realitetin shoqëror, që ngrejnë lart figurën pozitive të punëtorit; të fshatarit të ushtarit revolucionar, ose që demaskojnë klikën tradhëtare, borgjezinë e re sovjetike, sistemin e tyre burokratik, që t'i bëjnë thirrje klasës punëtore për veprimtari revolucionare, këto vepra nuk i lejon kush të ekspozohen. Ata artistë arrijnë, ndofta, të shprehen, aty këtu, tërthorazi dhe të nxjerrin në dritë ndonjë vepër me përmbajtje pak a shumë pozitive. Por kjo është një gjë e rrallë dhe e vështirë.

Artistët që qëndrojnë në anën e popullit, të klasës punëtore, me luftë revolucionare kundër klikës revizioniste do të gjejnë rrugët për të pasqyruar drejt realitetin sovjetik që veprat e tyre të lidhen me masat e gjëra të popullit punonjës, për t'i shërbyer revolucionit, komunizmit. të ardhmes.

Shkrimtarë të njohur

VIKTOR EFTIMIU

82 vjet më parë, një ditë janari, lindi në fshatin Boboshticë të Korçës Viktor Eftimiu. Në fund të shekullit të kaluar, familja e tij mori rrugën e mërgimit, për arsye ekonomike, dhe u vendos në Rumani.

Megjithse jetoi vetëm nëndë vjet në Boboshticë, kujtimet e fshatit të lindjes e ndoqën gjatë tërë jetës. Në vjershat e tij të para ndihet melankolia që i pruri mërgimi, atmosfera e zymtë e kohës me plaka të trishtuara dhe të vetmuara (se u kanë ikur djemtë në kurbet), me vajza që mbeten të pamartuara (sepse nuk kanë prikë), me pyje të rrafshuar.



KONFERENCA E KOMPOZITORËVE TË RINJ

Në Pallatin e madh të kulturës më 15-16 mars u zhvillua konferenca e kompozitorëve të rinj.

Raportin me temë «Mbi disa probleme të krijimtarisë së kompozitorëve të rinj» e mbajti kompozitori Feim Ibrahim. Në raport Feim Ibrahim, foli për aktivizimin e gjërë të kompozitorëve të rinj në jetën muzikore të vendit tonë.

Në fillim të raportit, pasi vuri në dukje, gjallërimin e mëtejshëm të jetës muzikore në vendin tonë dhe pasi theksoi kujdesin e veçantë që i kushton partia edukimit të shëndoshë të brezit të ri të artistëve, më poshtë ai tha:

«Të gjithë jemi të bindur për meritat e poemit simfonik «Alarme të përgjakura», të kompozitorit të ri Sh. Kushta. Poemi është një punë me përpjestime të mëdha, i realizuar me pjekuri dhe përgjegjësi.

Megjithëse është vepra e parë e kompozitorit, përsëri ai ka mundur të zgjidhë me sukses një varg problemesh lidhur me dramaturgjinë muzikore.

Poemi simfonik dhe kuarteti për harqe i Gj. Kapidanit, janë një përpjekje serioze që tregojnë se me punë e këmbëngulje mund të arrihet gjithshka. Koncerti për violinë i K. Larës paraqitet si një vepër me interes dhe si një përpjekje për të freskuar gjuhën muzikore.

Sonata për pianoforte, përpunimi i këngëve popullore dhe romancat e L. Dizdarit janë punë të mira që tregojnë se autori mund dhe do të japë më tepër në krijimtarinë muzikore. Poema për violinë dhe këngët e Sh. Kodrës të shtynë të shpresosh se autori do të ecë përpara».

Në raport u vlerësuan dhe puna e mirë e dirigjentëve F. Deda, E. Krantja, E. Dizdari, T. Sina, B. Lapi, K. Xhokaxhiu si dhe e instrumentistëve I. Madhi, Zh. Ciko, M. Deonizi, Gj. Antoniu, Gj. Shestani, L. Lazri, G. Laro, Gj. Pekmezi, A. Tartari etj. që përbëjnë një forcë të madhe që mund të ndihmojë në zhvillimin e mëtejshëm të muzikës sonë.

Më poshtë referuesi theksoi se mbështetja në truallin amtar është një kërkesë parimore, por njëkohësisht është e domosdoshme që shfrytëzimi i këngës popullore të bëhet me kriter të drejta ideo-profesionale, që ajo më parë duhet të kalojë nëpërmjet laboratorit krijues të kompozitorit.

Duke folur për tendencën pozitive të krijimtarisë së të rinjve, që realitetin ta pasqyrojnë me një gjuhë të freskët, me intonacione dhe emocione të reja, ai tha:

«Novatorizmin në krijimet tona duhet ta shohim në radhë të parë në përmbajtje, ashtu si

na mëson partia. Duhet pasur parasysh se gjithë këto suksese që kemi arritur deri tani, nuk do të mund të arriheshin pa përpjekjet këmbëngulëse të kolegëve tanë më të vjetër, pa muzikën tonë popullore të bukur e të lashtë».

Në vazhdim u mbajtën temat: «Në krijimtarinë tonë të mbështetemi në tokën amtare» nga Çesk Zadeja dhe «Për një kultivim më të mirë të shijeve ideo-estetike» nga Spiro Kalemi.

Çesk Zadeja tha se muzika jonë gjithmonë është mbështetur në traditën popullore, por njëkohësisht ai shprehu mendimin se mbështetja në këtë traditë nuk duhet të përqëndrohet vetëm në anët e jashtëme, në mjetet shprehëse dhe te kadenca, por kryesisht në thelbin e kësaj tradite, në frymën e saj të përgjithëshme, në filozofinë dhe idetë e saj, në problemet dhe aspiratat. Mbështetja në folklor duhet të shërbejë edhe për të gjetur një gjuhë më shprehëse, më komunikuese, më efikase për të shprehur mendimet dhe emocionet e kohës sonë.

Në referatin e tij S. Kalemi preku probleme të krijimtarisë muzikore dhe të shijes artistike të masave duke vënë në dukje se kompozitorët duhet të krijojnë vepra muzikore ku të reflektohet realiteti ynë, koha jonë, idetë e kohës sonë, se ata me muzikën e tyre duhet të luajnë

një rol të rëndësishëm në drejtimin dhe formimin e shijes estetike të masave punonjëse.

Në takim e morën fjalën edhe shokët L. Dizdari, P. Kokalari, J. Minga, S. Çefa, T. Hoshafi, A. Peçi, L. Sato, A. Paparisto, A. Topçiu, M. Denizi, N. Bulo etj.

Ata diskutuan për probleme të ndryshme të krijimtarisë muzikore, shprehën mendime për një organizim më të mirë të jetës muzikore, që kompozitorët e rinj duhet ta lidhin me shumë krijimtarinë e tyre me jetën e popullit, të njohin e të mbështeten më shumë në krijimtarinë popullore, të mësojnë nga ajo

Në fund, e mori fjalën sekretari i përgjithshëm i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, Vilson Kilica, i cili përqëndroi vëmendjen më shumë në karakterin popullor të muzikës sonë. Ai theksoi mendimin se karakteri popullor kryesisht duhet të shikohet në brendinë, në përmbajtjen e muzikës, në idetë që e përshkojnë atë. Ajo do të shkojë tek populli dhe do të bëhet e afërt për të nëse pasqyron problemet, preokupimet dhe aspiratat e tij. Gjithashtu, mbështetja në krijimtarinë popullore, tha ai, do ta pasurojë më shumë muzikën tonë, do ta bëjë më të kuptueshme për masat, do të forcojë më shumë karakterin e saj popullor.

Koresp. i «Nëndorit»

OLIMPIADA TEATRALE E TIRANËS, 1971

Për çdo vit, është bërë traditë organizimi i olimpiadës teatrale në Tiranë, dhe pikërisht në stinën e pranverës. Kësaj here ky aksion i madh artistik u organizua në kuadrin e 30-vjetorit të themelimit të Partisë sonë të lavdishme dhe të Kongresit të saj të gjashtë

Karakteristikë kryesore e tij është masiviteti i pa parë gjer më sot, gjithsejt 131 grupe teatrale të qëndrave të punës dhe të fshatit duke përfshirë grupet e shkollave.

Masivizimi i gjërë u duk jo vetëm në shtimin e grupeve, por edhe në pjesëmarrjen e gjërë të punëtorëve, kooperativistëve, nëpunësve, intelektualëve dhe të vajzave e grave.

Afër dhjetë ditë me radhë skena e Teatrit popullor u kthye në një tribunë të zjarrtë ku buçiti e fuqishme fjala dhe mendimi i kohës. Ndryshe nga olimpiadat që organizohen nga trupat profesioniste, ku herë herë sundon zyrtarizmi dhe akademizmi, në këtë olimpiadë mbizotëronte optimizmi, guximi, një atmosferë e këndëshme, pasioni, dhe dashuria e amatorëve për teatrin. Kjo nuk u duk vetëm në frekuentimin e shfaqjeve, por edhe në dhënien e spektakleve të ndryshëm.

Të shumtë qenë grupet që konkuruan. Është e vështirë të flasësh për të gjithë.

Në këtë olimpiadë, krahas pjesëve të njohura nga repertori ekzistues si: «Mbi gërmadha», «Mulliri i Kostë Bardhit», «Studentja e vitit të fundit», «Qieli i kuq», «Hijet e natës», «Të pamposhturit» etj., u shfaqën edhe pjesë të reja si: «Kur po lindëte qyteti», nga Ferdinand Radi, «Një natë pa gjumë» nga Vladimir Prifti, «Komsinjtë të rinj, avaz i vjetër» nga

Miho Gjini, «Miqtë» nga Kujtim Shehu, etj.

Tematika ish e gjërë, e lar-me, duke përfshirë periudhën që nga koha e luftës e këtej, pjesët e ndryshme i bënin jehonë aktualitetit tonë revolucionar dhe shërbenin më së miri për edukimin ideoestetik të masave të gjëra. Ky është një tipar tjetër pozitiv i lëvizjes artistike teatrale amatore, të cilën e karakterizon qartësia dhe mprehtësia ideologjike. Edhe në repertorin e ri, shihej se me sa guxim dhe zgjuarsia trajtohen disa probleme të rëndësishme të kohës sonë. Mjafton të përmendim dramën e Ferdinand Radit «Kur po lindëte qyteti», e cila shtron problemin e emancipimit të gruas duke e parë atë nga pozita më të avancuara. Lizën, protagonistin kryesor, e ndan i fejuari i dytë konservator nga opinioni i keq, se ajo paska qenë e fejuar më parë, gjë të cilën ai e dinte që në fillim. Liza proteston për këtë, ndonëse trishtohet. Protesta e saj shprehet në këtë: pse djali paska të drejtë të pyesë si e qysh për të kaluarën e vajzës, ndërsa kjo e fundit jo Kurse mërziçja e trishtimi i vjen nga që ajo nuk e koncepton dot dashurinë kur futen midis saj lloj lloj pyetjesh. Dashuria me Niazun hedh dritë mbi shumë çështje, sqaron shumë gjëra dhe godet disa plagë të vjetra, si konservatorizmin, patriarkalizmin, të cilat ekzistojnë në forma të ndryshme jo vetëm tek ish i fejuari i dytë, por edhe tek të tjerët.

Po kështu edhe komedia «Miqtë» e Kujtim Shehut, ngjarjet e së cilës zhvillohen në Moskë, satirizojnë me guxim bashkëpunimin sovjetiko-amerikan. Nëpërmjet një fabule të

thjeshtë të vizitës së dy specialisteve amerikanë që vijnë për shkëmbim eksperience në një ndërmarrje sovjetike, autori gjen shkas për të goditur degjenerimin moral-politik në shumë fusha të jetës.

Përmbajtja e shëndoshë e partishme, e repertorit është e pa ndarë edhe nga interpretimi i tij skenik. Duke marrë parasysh grupet më të mira të kësaj olimpiade, themi pa frikë, se ajo pati suksese të reja në drejtim të rritjes së mjeshhtërisë artistike si në çështjet e regjisë ashtu edhe në ato të aktorit. Ndër shfaqjet më të mira mund të radhisim: shfaqjen «Kur po lindëte qyteti» të Uzinës «Partizani», «Hijet e natës» të Radio-Televizorit, «Miqtë» nga N.T.SH.U.S.-i dhe Ndërmarrja artistike «Migjeni», «Të pamposhturit» nga grupi teatral i N.SH.N.-së «21 Dhjetori» dhe i Uzinës së ushtrisë, etj.

Në shfaqjen «Kur po lindëte qyteti», regjizori i së cilës ishte Albert Minga, vihej re një konceptim regjizorial i qartë, i bukur, ekspresiv, ku zbulohet artistikisht domethënja ideoartistike e dramës. Në këtë shfaqje të bie në sy trajtimi realist i lërë materialit, figurave e personazheve të shprehura këto me një gjuhë regjizoriale të pasur, të thjeshtë, nga një mizanskenë e zhdërvjelltë dhe me prirje origjinale, nga vendosja e theksave logjike dhe evidencimi i problemeve e ngjarjeve kryesore si dhe i momenteve dramatiko-emocionale. Në një lartësi të tillë ishte dhe interpretimi artistik nga aktorët amatorë të kësaj shfaqjeje Një lojë e thjeshtë, pa rënë në lthjeshtëzim, e natyrshme, e qartë dhe konkrete.

Krahas kësaj shfaqjeje radhitet dhe ajo e Radio-televizorit «Hijet e natës» me regjizor Reshat Arbanën. Ndonëse zgjidhja regjizoriale e spektaklit e

konceptuar si një dramë satirë ishte një meritë ideore e shfaqjes, prapë regjia mund të kish bërë më shumë. Përsa i përket interpretimit të aktorëve, kjo shfaqje ish në lartësinë e trupave profesioniste. Le të marrim vetëm interpretimin e rolit të Tushes nga aktorja e talentuar Vera Zhej. Plastikë e shkëlqyer, zë të qartë, të bukur dhe të kumbueshëm, shpërthime emocionale të fuqishme, veprim konkret sipas rrethanave të dhëna, harmonizim i fjalës, i mendimit dhe lëvizjes — të tëra këto të shkruara në unitet me figurën e Tushes.

Bukur interpretuan edhe Merkur Bozgo e Kiço Fotiadhi në këtë shfaqje. Të një niveli të tillë ishin edhe disa amatorë të tjerë në disa shfaqje si: Justina Aliaj, Ferdinand Radi, Fatbardha Lalo, Albert Minga, Rushan Xhemali, Kondo Kondi, Shpëtim Markola, Flora Kacadej, Nexhat Majellari, Lulzim Vojka, Donika Rako, Maria Peqini, Edmond Sala, Bedri Topi, Randi Siku, Shpresa Martini etj.

Në përgjithësi, si në konceptimin regjizorial ashtu edhe në lojën e aktorëve prirjet drejt realizmit duhen vlerësuar si diçka pozitive, si një hap përpara të teatrit amator. Natyrisht kjo prirje nuk ishte në të tëra grupet, por siç thamë më sipër, duke marrë në konsideratë grupet më të mira. Një ndihmë të madhe padyshim ka dhënë edhe trupa e Teatrit popullor.

Lufta që po bën teatri amator, drejt rritjes së cilësisë artistike është një kërkesë e vetë kohës sonë. Megjithatë është e udhës të thuhet se akoma mbetet shumë për të bërë, akoma ka grupe që dalin në skenë me një nivel të ulët artistik, ku mbisundon kantilena, deklamacioni, pompoziteti, «mbeturina» këto të teatrit të vjetër. Gjith-

ashtu edhe regjia në mjaft grupe la për të dëshiruar.

Duhej që krahas zgjerimit të kësaj lëvizjeje, të mendohej dhe për rritjen e cilësisë artistike. Kjo është një çështje që në momentin e tanishëm, me 131 grupe teatrale në rrethin e Tiranës, merr rëndësi të dorës së parë.

Një çështje tjetër e kësaj olimpiade që nxori krye në mëse pesë-gjashtë grupe, ishte dhe ndryshimi që u ishën bërë disa pjesëve. Është e ditur që teatri do të ndihmojë autorin me sugjerimet e tij, me vërejtjet konkrete, por në asnjë mënyrë ai nuk duhet të vejë dorë mbi pjesën, ta ndryshojë e ta përpunojë sipas dëshirës së vet, pa lejen e autorit. Ky është një problem serioz, i rëndësishëm

dhe i mprehtë. Kishte raste kur autori në pjesën e tij e kishte ndarë çiftin, sepse e shikonte si të pamundur bashkëjetesën në marrëdhënje të tilla, kurse grupi amator i bashkonte si pa gjë të keq dhe krejt në mënyrë artificiale. Ndryshime të dëmshme ishën bërë p.sh. në pjesët: «Ajo zgjodhi këngën», «Mina», «Një natë pa gjumë», «Miq-të», «Një natë me shi» etj. Këto ndryshime kishte raste kur shtrembëronin dhe domethënien ideoartistike të pjesës.

Por me gjithë këto dobësi, olimpiada teatrale amatore e qytetit të Tiranës që një sukses i mëtejshëm i kësaj lëvizjeje të gjërë që çdo ditë e më tepër po bëhet e masave dhe për masat.

Mexhid Prençi